



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 32

Datë: 16. 05. 2024.

Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z .Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 29, 30 dhe 31 /2024**
- 3. Aktivitetet e SKQZ**
- 4. Aktivitetet e Zyrës**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për regjistrimin e partisë politike: ZA SLOBODU PRAVDU I OPSTANAK

5. Raport i Këshillave të KQZ

Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për punëtorinë për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut;

5.2.Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për punëtorinë për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimin për asgjësimin e materialit zgjedhor të procesit të votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut
 6. **Kërkesë për autorizimin e Sekretariatit për lidhjen e marrëveshjes me palë të treta**
 7. **Të ndryshme !**
-

1. Hyrje: z .Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Fillimisht, kryetari Kreshnik Radoniqi tha se, në këtë mbledhje mungojnë anëtarët alban Krasniqi dhe Arianit Elshani, ndërsa që pastaj paraqiti agjendën e mbledhjes.

Lidhur me rendin e ditës, **Sami Kurteshi** tha se ‘e kam dërguar miellin për ju’, dhe si ‘njoftim, meqë më keni obliguar, ka të bëjë me anëtarësimin e KQZ në organizatën e Frankofonisë ! Gjithashtu, sa di unë, kolegu Arianit Elshani ka bërë edhe kërkesa...

Kreshnik Radoniqi: Po, te KOZ, z. Elshan te pika ‘Për punëorinë’ ka kërkuar të ndryshohen titulli i kësaj pike. Kërkon që agjenda të trajtohet në KOZ, por në parim ‘data, rendi, buxheti të miratohe’.

Ilir Gashi tha se, propozimi është në rregull sepse në KOZ kemi kërkuar më shumë të trajtohet çështja e zgjedhjeve parlamentare, pavarësisht se kur mbahen ato, më shumë se çështja e votimit që ishte në veri më 21 prill...! Kështu që unë, pajtohem me propozimin e z. Elshani...

Me 8 vota për, anëtarët e KQZ miratuan agjendën e takimit. Gjithashtu, në vazhdim u miratuan edhe procesverbalet: 29, 30 dhe 31 /2024.

2. Aktivitetet e SKQZ

Burima Ahmetaj, tha se lidhur me aktivitetet, jemi duke analizuar të dhënat e Ekstaktit, si është gjendja dhe cilat janë kategoritë që janë shtuar numri i votuesve. Raporti po përgatitet me të gjitha të dhënat. Jemi duke përgatitur edhe finalizimin e projektit për furnizimin me kamera në vendvotime. Është duke u shqyrtuar në DOZ, dhe pastaj edhe në KQZ për votim dhe pastaj, ta dërgojmë në prokurim.

Një aktivitet tjetër, është edhe mundësia e vëzhgimit të zgjedhjeve evropiane në ambasadën e finlandës. Ministria e Drejtësisë, autoriteti i zgjedhjeve, ka pranuar që KQZ ti vëzhgojë zgjedhjet evropiane përmes ambasadës finlandeze në Prishtinë nga data 31 maj, deri më 1 qershor.

Sami Kurteshi pyeti se, a është djala me i marrë nga shqipëria, apo...?

Burim Ahmetaj, tha se KQZ e ka planifikuar buxhetin, dhe po institojmë që ti blejmë ato për proceset e ardhshme.

Kreshnik Radoniqi: A ka naj propozim lidhur me përcjelljen e zgjedhjeve evropiane në ambasadën finlandeze ? Unë, do e propozoj Albania dhe Arianitin. Dhe, mendoj edhe dikush nga Sekretariati.

Kush është për...?

Me 9 vota për, u miratua vëzhgimi i zgjedhjeve evropiane në ambasadën e Finlandës në Prishtinë.

3. Aktivitetet e Zyrës

Valmira Selmani, zyrtare tha se sot rekomandojmë nismën e re për regjistrim “Za slobodu pravde i opstanak”. Kjo nismë, ka aplikue me kohë dhe sipas ligjit. Subjekti, udhëhiqet nga Nenad Rashiq. Kemi shqyrtuar statutin, aktin e themelimit, programin si dhe raportin financiar. Ky subjekt, ka ulëse në Parlament dhe është e liruar nga nënshkrimet, dhe pagesa.

Në bazë të dokumentacionit, nisma ka qenë edhe në shqyrtim publik. Nuk ka pas ndonjë ankesë, dhe ne rekomandojmë për regjistrim.

Kreshnik Rdoniq: A kush ndonjë pyetje?

Gordana Llaban, pyeti rreth dokumentacionit, nënshkrimet, pagesa...!

Valmira Selmani: Me ligj të ri, iniciativat regjistrohen si parti.

Me 8 vota për, dhe 1 abstenim regjistrohen kjo iniciativë si parti politike.

4. Raport i Këshillave të KQZ

Këshilli për Buxhet dhe Financa

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit për punëtorinë për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut;

Gordana Llaban, tha se në takimin e 10 –të të këshillit, janë shqyrtuar dy pika. E para, për punëtorinë për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut. Buxheti për këtë punëtori, është 14,041 euro. Rekomandojmë për miratim.

Ibrahim Selmanaj: Ne duhet ti përmbahemi diskutimit, të ndërrohet agjenda dhe të shohim si të vijojmë për zgjedhjet e reja që na presin. Atë që e ka thënë edhe z. Elshani...

Sami Hamiti: Është çështje e procedurave. Nuk ndryshon asgjë, veç emri.

Burim Ahmetaj: Një propozim, meqë lidhet me KOZ. Ishte një i planifikuar nga Zyra, por propozoj që të shtohet edhe një. Ndërron buxheti...

Kreshnik Radoniqi, u interesua rreth datës, 23-26 që tha se, nuk është e përshtatshme...

Anëtarët e KQZ-së, votuan për përgatitjen edhe lidhur me zgjedhjet parlamentare, dhe që të shtohet edhe një zyrtar nga Zyra.

5 Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për punëtorinë për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut:

Burim Ahmetaj, tha se KOZ-i e ka shqyrtua projektin për punëtorinë për mësimet e nxëna për procesin e votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut, si dhe për zgjedhjet parlamentare. Ajo çka rekomandohet, është data: 23-26 maj, si dhe numri i pjesëmarrësve që është: 30 zyrtarë. Agjenda, do të shqyrtohet edhe njëherë në KOZ.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan planin e puëntorisë me 9 vota.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimin për asgjësimin e materialit zgjedhor të procesit të votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut:

Burim Ahmetaj: Është shqyrtuar edhe kjo pikë, e që lidhet me asgjësimin e materialeve, por edhe regjistrimet që janë bërë përmes kamerave, pamjet e regjistruara. Ai tha se, në një vendvotim, pamjet janë shqyrtuar dhe se, është analizuar që të ruhet për arsye të caktuara – si mostër...

Sami Kurteshi: A ka pasur ndonjë ankesë, me ato që lidhen me regjistrimin e kamerave...?

Burim Ahmetaj: Jo, nuk kemi pranuar asnjë ankesë, nga asnjë institucion.

Sami Kurteshi: Unë jam për ta ruajtur, mirëpo të anonimizohen fytyrat e caktuara, dhe të shihet se ato regjistrime, a mundën me pas ndonjë anë negative. Por që, askush nuk duhet të jetë i rrezikuar, dhe të kihet kujdes...

Ilir Gashi, tha se, kjo mostër nuk hynë në punë asgjë. Pse do duhej të ruhej, dhe sa është në rregull me ligjshmërinë, me privatësinë...? Nuk mendoj që na hyn në punë një ekzemplar...

Burim Ahmetaj, tha se në KOZ është folë vetëm për analizë, thjeshtë teknike, si ka funksionuar kamera dhe jo për ndonjë qëllim tjetër... Por, ta pyesim edhe Agjencionin e Privatësisë, ta kemi një opinion...

Në këtë pikë, diskutuan edhe Qemajl Kurtishi që tha se nëse është çështje e analizës, pse jo! Ndoshta gaboj, por nuk shoh ndonjë problem...

Kreshnik Radoniqi: Kur e kemi votue në fillim, ka qenë vendimi që materiali të shkatërrohet. Ne po e votojmë, e pastaj, për ruajtjen e shohim në ndonjë mbledhje tjetër...

Kush është për miratimin e materialit zgjedhor ?

Me 9 vota për, u miratua asgjësimi i materialit zgjedhor të procesit të votimit për apo kundër largimit të kryetarëve të komunave në Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut:

6. Kërkesë për autorizimin e Sekretariatit për lidhjen e marrëveshjes me palë të treta:

Burim Ahmetaj: Pas miratimit të rregulloreve të brendshme, Sekretariati i është nënshtruar procesit të sistemit. Para këtij procesi, znj. Daku ka qenë personi kryesorë financiarë, dhe z. Nika në funksionin e zyrtarit certifikues. Tash, me miratimin e rregulloreve dhe sistemit, z. Nika që është edhe udhëheqës

Divizionit për financa dhe udhëheqës financiar, e znj. Daku, zyrtare certifikuese. Edhe ministria e financave, ka dërguar imell që duhet të kemi kujdes. Pra, lëndët e autorizuara nga znj. Daku, tani nuk mund të bëhen nga zyrtarja e njëjtë, prandaj na duhet leja e KQZ që të lidhim marrëveshja me palët e treta. Fjala është për Avokatin e Popullit që ka dhënë kontribut, dhe ne kërkojmë që ne të lidhim marrëveshje që ky institucion, ti kryejë këto lëndë që dikur si ZKF i ka iniciuar znj. Daka.

Në këtë pikë diskutuan: Ilir Gashi, Burim Ahmetaj, Kreshnik Radoniqi.

Me 8 vota për, miratohet kërkesa e Sekretariatit për lidhje të marrëveshjes me palë të treta.

7. Njoftim

Sami Kurteshi, e informoi KQZ-në lidhur me takimin “On line” me Rrjetin e Trupave Menagjuese të Vendeve Frankofone, dhe Rrjeti i Frankofonisë – Zgjedhjet Nacionale ku merrnin pjesë mbi 45 persona. Tema e takimit ishte bashkëpunimi i trupave menagjuese zgjedhore, vëzhguesve të zgjedhjeve, shoqërisë civile. Kishte prezantime, përvoja, bashkëpunime të paraqitura të angazhimit të shoqërisë civile në zgjedhje, transparenca, integriteti i zgjedhjeve. Ka probleme. E unë, shkurtë i falënderova, dhe besoj që ata do t’i kryejnë çështjet procedurale. Unë, thash që do të bashkëpunojmë...

8. Të ndryshme !